Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Bujar Lushaku	**11.08.2023**	**17.08.2023**	**2023/0559**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.08.2023, OE “" Pylla " SH.P.K.”- Gjilan , ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0559, kundër (B58) njoftimit mbi vendimin e AK-së për OE të rekomanduar për kontratë OE “" Wood Company " SH.P.K.”- Marec Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me dru dhe pelet” (Lot 1 Furnizim me dru) me nr. të prokurimit: "651-23-4592-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontrates:391,920.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ankues: OE " Pylla " SH.P.K.”- Veleknicë- Gjilan,

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues: “Pylla " SH.P.K.”- Prishtinë janë:

Neni - 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni - 59 i LPP-së

Neni – 62, pika 1 dhe 1.1 Anulimi i aktivitetit të prokurimit

Neni - 69 i LPP-së

Neni – 72, Dokumentacioni dhe informata sqaruese sipas LPP-së

AK me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe atë të neneve si më poshtë:

Konsiderojmë se AK- Komuna e Gjilanit- Departamenti i Prokurimit gjatë ushtrimit / udhëheqjes së procedurës së prokurimit për këtë lëndë përmes marrjes së vendimit:

1) Letër standarde për tenderuesit e eliminuar "P Y LL A" shpk-Gjilan të datës 25/07/2023, ka dëmtuar interesin e ligjshëm të OE "P Y LL A" shpk-Gjilan ngase nuk i ka marrë masat e nevojshme për sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminues në mes të OE pjesëmarrës duke shkelur parimet bazike të prokurimit publik dhe qëllimet e ligjit të prokurimit publik, andaj duke u bazuar në rrethanat faktike dhe vërtetimit të gjndjes faktike të argumentuar/provuar edhe me dëshmi mbi atë që ka ndodhur në të vërtetë, fakte bindëse që hudhin poshtë arsyetimin e dhënë nga AK përmes vendimeve dhe parashtresave tjera konsiderojmë se AK ka bërë Shkelje të dispozitave të LPP-së dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji duke përfshirë rregullat e prokurimit publik edhe atë:

Neni 7 BarazianëTrajtim/ Jo-Diskriminimi iligjit të P.Publiknr. 04/L-42, 04/L-237 ; 04/L-068 dhe 05/1.-092\

Nenin 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve 04/L-42, 04/L-237 ; 04/L-068 dhe 05/L-092\

Nenin 62, pika 1 dhe 1.1 Anulimi I aktivitetot të prokurimit 04/L-42, 04/L-237 ; 04/L-068 dhe OS/L-092\

Neni 69 aftësia teknike ose profesionale 04/L-42, 04/L-237 ; 04/L-068 dhe 05/L-092\

Neni 72 Dokumentacioni dhe informata sqaruese 04/L-42, 04/L-237 ; 04/14-068 dhe 05/1.-092\

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ju njoftojme se me datën 10/07/2023 kemi marr një vendim nga Njësia e Prokurimit mbi përgjegjjen në kërkesën tonë për Ryshqyrtim ku autoriteti kontraktues ka konstatuar se ankesa e jonë është e ligjshme dhe ka gjet shkelje të Ligjit të Pokurimit Publik tëKosovës si në nenet që i kemi cekur më lartë.Mirpo për befasi tonën komisioni rivlersues prapë nuk e ka bërë egzaminimin e dokumetacionit të kompanis fituse fare por neve si kopmani kinse e përgiegjshme na ka eliminuar për tejkalim të buxhetit dhe me të njejtin vendim na ka njofuar përmes një Letër standarde për tenderuesit e pasukseshëm nga Autoriteti Kontraktues me datën 25/07/2023,

Ndërsa kërkesën e dytë për ryshqyrtim na e ka refuzuar.

Mirpo Autoriteti Kontraktues respektivisht komisioni rivlersues gjatë egzaminimit të ofertave

nuk kanë qen objektiv gjat analizes së ofertave dhe neve si kompani na kanë eliminuar në kundërshtim me LPP dhe e kanë shpërblyer një kompani e cila nuk i ka plotësuar në plotëni kushtet e tenderit në këtë rast "WOOD COMPNY" shpk nga Prishtina e cila edhe pse me çmim ka qen ma e lir por nuk i ka plotësuaer kushtet dhe kriteret e parapara në dosjen e tenderit edhe atë nuk ka prezentuar asnjë referencë përveq listës së referencave qka ka qen në kundërshtim me dojen e tenderit (Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e susksesesshme te furnizimeve.

Shënim: Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 Lote, shuma më e lartë e vlerës që kërkohet për Lotet për të cilat konkurron duhet të përmbushet nga OE.

- Gjithashtu edhe në dosjen e tenderit është kërkuar që ofetuesit të paraqesin listen e mekanizimit të kërkuar Kompania fituse nuk ka prezentuar anjë dëshmi mbi posedim e e mekanizimit të paraparë përveq se një listë të mekanizimit ku ka bërë shkele të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës (Deshmia 5 Dokument valide per qarkullim dhe e lexueshme kopja, marrëveshje për huazim apo kontrate ose dud doganor)

-Gjithashtu Kompania fituse nuk ju ka përmbajtur kritereve tekniko-profesionale për stafin teknik ku e njejta ka dorëzuar vetëm një list të punëtorëve kurse nuk i ka dorëzuar kontratat e nënshkruara dhe vulosura nga palët kontraktuale ashtu Siq është kërkuar në Dosjen e tenderit.

(Dëshmia 2. Listë e puntorëve - teknik e cila duhet të jetë e nënshkruara dhe e vulosur, për të gjithë puntorët duhet dëshmuar Kontrata apo Parakontrata e punës e nënshkruar nga Punëmarrësi dhe Punëdhënsi si dhe e vulosur nga Punëdhënsi të dorëzohen në kopje).

Ne mendoimë se Komisioni Rivleruuesme qdo kushtë ka dashtë kompanin "WOOD COMPNY" shpk ta shpërblej me kontratë pasi që gjatë egzaminimit të tenderit dhe dokumentacionit të kompanis në fjal ka kërkuar që dokumentacionin tenderik ta plotësoj me dokumente shtesë disa here dëshmi shkresat e lëndës në kundërshtim të LPP nenit 72 dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik nr. 001/2023 nenit 10 pika 1 ku në mënyr taksative është përcaktuar se qka kërkohet informata shtesë e qka jo (shiqo tabelen) pra kompania fituese nuk e ka patur dokumentacionin e duhur ku ka bërë shkelje bazike të Dosjes së tenderit dhe e njejta ka qen dashur të eliminohet qysh në startë. Kompania fituese gjat dorzimit të dokumentacionit ka bërë shkelje duke i dorëzuar :

I.Listen e referencave (pa asnjë referenc ku në listë i ka patur ma tepër se 10 referenca dhe nuk e ka dorëzuar asnjë).

2. Listen e mekanizimit e ka dorëzuar pa asnjë dëshmi mi posedimin e mekanizimit,

3.Listen e punëtore gjithashtu e ka dorëzuar pa asnjë dëshmi. (kjo dmth se nëse më mungon dokumentacioni un e dorëzoj pas hapjes së ofertave, logjike kish me qen një ose dy referenca nëse mungojn nga lista atëher i kërkohet dokumentacion shtes e njeta gjë vlen edhe për mekanizimin dhe listen e punëtorëve e jo i tër dokumentacioni të kërkohet pas dorzimit të ofertave ku qartë po vërehet qëllimi i AK që ta shpërblej me kontratë me qdo kushtë).Autoriteti kontraktues ka manipuluar me nenin 72. Dokumentacioni dhe informata shtesë të LPP ku ky nen thot se duhet të plotësohet me ndoj

paqartësi të dokumentacionit e jo me 80 % të dokumentacionit të plotësohet pas dorzimit të ofertave).

Njëherit Kompanin tonë e keni eliminuar padrejtësishtë siq e tham edhe më lartë për kinse tejkalim të Buxheti sa per dioni të Autoritetit kontraktues nëse ka qen dashur me u elimuar Kompanin "Pylla"shpk atëher këtë aktitvitet të prokurimit ka qen dashur ta anuloj në tërësi dhe të përsëris pasi që kompania fituese nuk i ka plotësuar kushtet e tenderit (shiqo dokumentacionin e kompanis fituse Dëshmia 2. Listi e puntorëve - teknik e Cila duhet të jetë e nënshkruara dhe e vulosur, për të gjithë puntorët duhet dëshmuar Kontrata apo Parakontrata e punës e nënshkruar nga Punëmarrësi dhe Punëdhënsi si dhe e vulosur nga Punëdhënsi të dorëzohen në kopje). Ky dokumentacion me LPP neni 72 dhe Udhëzues të Prokurimit Publik neni 10 nuk guxon të kërkohet pas dorëzimit të tenderit shiqo tabelen qka guxon të kërkohet e qka jo) pra kompania e Cila është propozuar të shpërbëlehet me kontratë është kompani e pa përgjegjshme.

P.S.

Kompania e joni disa here fizikisht ka qenë në Departamentin e Prokurimit për me kërkue sqarime shtesë mbi specifikacionin e tenderit pasi që i njejti ka qen i pa kjartë dhe konfuzë pasi që nuk është ditur se si do të bëhet liferimi i druve a në metër/kub apo në metër /hapsinor (shiqo specifikimin etkni të dosjes së tenderit). Përkundër interesimit tonë departamenti i prokurimit nuk na ka dhënë sqarime shtesë se si duhet të veprohet me sasin e druve dhe si do të bëhet liferimi e tyre pasi që ne gjithëherë më parë (herët) i kemi liferuar drutë në m/hapsinor e jo në m/kub.

Sa per skjarim "Pylla"shpk nga Gjilani ne këtë aktivitet te prokurimit ka ofertuar me Mkub që i bie 77.00 €për metër kub që dmth se 1 m/kub dru= 1.43 m/hapsinor dru. Kur te shëndrrohet çmimi i jon në m/hapsinor i bie se kemi ofertuar me 53.85 € per m/hapsinor.

Kostatojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartëshenuara të LPP dhe akteve tjera nënligjore, si pasojë e të cilave ka ardhë deri te dëmtimi OE" PYLLA" shpk Gjilan , andaj kërkojm nga Organi Shqyrtues i Prokurimit pas shqyrtimit dhe marrjes në konsiderat ankesen tonë si dhe duke ju dhënë peshë të gjitha fakteve të paraqitura në ankesë propozojmë të mere këtë:

VENDIM

MIRATOHET: si e bazuar ankesa e OE" PYLLA" shpk Gjilan e datës 09/08/2023

ANULOHET: letra standarde mbi tenderuesit e eliminuar e datës 25/07/2023

Anulohet : vendimi mi kërkesen tonë për ryshqyrtim 02/08/2023

VENDOSET: të merren masa adekuate korigjuese për eliminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendoset të shpërblehet me kontratë OE" PYLLA" shpk Gjilan si ofertuesi i përgjegjshëm me çmimin ma të lirë që i ka plotësuar të gjitha kriteret në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Ose

Të bëjë anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhë të filloj me aktivitet të ri të prokurimit.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kërkesa

1 .Operatori ekonomik duhet te ofroj deshmi per realizimin e furnziimit te ngjajshme per tri vitet e fundit(duke filluar nga data e publikimit te njoftimit per kontrate) me vlere minimale për LOT 1 -500.000.00 € LOT 2- 300 000,00 € Ne rast te ofertimit si Grup i OE-ve (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në furnizime të ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit.

Dëshmia

1 Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e susksesesheme te furnizimeve .

Kërkesa

2. Operatori ekonomik duhet të ketë puntor-teknik në të cilët mund të thirret për zbatimin e ketij aktiviteti, pavarësisht se a i takojnë Operatorit Ekonomik dhe atë për minimum shtatë (7) punëtorë-teknik .

Dëshmia

2. Listë e puntorëve - teknik e cila duhet të jetë e nënshkruara dhe e vulosur, për të gjithë puntorët duhet dëshmuar Kontrata apo Parakontrata e punës e nënshkruar nga Punëmarrësi dhe Punëdhënsi si dhe e vulosur nga Punëdhënsi të dorëzohen në kopje.

Kerkesa

3. Për Lot 1 dhe Lot 2 OE duhet te posedoj mjete te punes ne dispozicion per realizimin e furnizimeve 2 kamion

Deshmia

5 Dokument valide per qarkullim dhe e lexueshme kopja, marrëveshje për huazim apo kontrate ose dud doganor

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Pasi që sipas DT dhe NJK kriter per dhenjen e kontrates është oferta e pergjegjëshme me çmim ma te ulët ,komisioni per ekzaminim dhe vlerësim dhe krahasimin e tenderëve i rekomandon zyrtarit pergjegjës të prokurimit që me kontratë të shperblehet ne Lot 1 Furnizim

me dru -grupi i operatoreve „Word Company shpk Lagjia vitija Marec Prishtinë i cili ka dorëzuar ofertën e tij të pergjegjëshme me çmim më të ulët sipas vlerës së ofertuar prej 382,455.70€

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE Ankues është palë me interes.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" Pylla " SH.P.K.**

Përgjigje në Pretendimi nr.1 .

Operatori Ekonomik Pylla sh.p.k - Gjilan - pretendon se Autoriteti Kontratues Komuna e Gjilanit - Departamenti i Prokurimit nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së ,

Eksperti thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është që autoritetet kontraktuese do ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në menyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit .

Pretendimi i OE ankues lidhur me shkeljen e ketij neni është permendur vetem sipërfaqsisht pa e specifikuar se qka nuk ishte në harmoni me nenin 7 të LPP-së.

Eksperti sqaron se me rastin e ekzaminimit të landës nuk është vërejtur se AK ka bërë ndonjë veprim që bjen ndesh me nenin 7 të LPP-së .

Andaj,

Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.2/4 .

Operatori Ekonomik Pylla sh.p.k - Gjilan - pretendon se Autoriteti Kontratues Komuna e Gjilanit - Departamenti i Prokurimit nuk e ka respektuar nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së ,

Eksperti thekson se qellim ineni 59 është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të Vlerësimit ,pasi ka pranuar kerkesën për rishqyrtim dhe landën e ka kthye në rivlerësim ka themeluar komision për Rivlerësim .

Eksperti thekson se qellim i neni 72 është (mundesia e sqarimit) Dokumentacioni dhe informacioni shtesë : Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Shihë pretendimin e OE ankues i njejti pretendon se OE i shpallur fitues nuk i ka plotësuar kushtet e tenderit sepse :

1. Nuk ka prezentuar asnjë referencë përveq listes së referencave .

2. Nuk ka prezentuar deshmi mbi mekanizmin e paraparë përveq listen e mekanizmit

3. Gjithashtu OE fitues nuk e ka plotësuar kriterin sa i stafit teknik ku e njejta ka dorëzuar vetem një listë te punetorëve kurse nuk ka dorëzuar kontratat e nenshkruara dhe te vulosura nga palet ashtu siq janë kerkuarë.

4. I njejti pretendon se oferta e OE ankues nuk e ka tejkaluar buxhetin e paraparë sepse i njejti thekson se ka ofertuar me meter /kub që i bie 77.00€ per meter kub qe do me than se 1m kub dru =1.43 meter hapsirë.

Eksperit sqaron se sa i perket tri pretendimeve të para te njejtat janë të pa bazuara sepse kur dorëzohet lista e kontratave sipas nenit 59 ,dhe nenit 72 të LPP -së si dhe bazuar në udhëzuesin nr 001/2023 për prokurim publik konkretisht neni 10 sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve perkatsisht te rreshti i parë i kesaj tabele shkruan se :

Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara Mund të kërkohen informata sqaruese 69

OE i shpallur fitues siq e ka permendur edhe OE ankues ka dorëzuar listat dhe AK bazuar ne nenin 59 dhe 72 si dhe bazuar në udhëzuesin nr 001/2023 për prokurim publik konkretisht neni 10 sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit i ka kerkuar edhe deshmit per listen e kontratave ,per listen e makinerisë dhe për listen e punëtorëve .

AK gjatë vlerësimit ka qenë i detyruar të i kerkojë deshmit që janë prezentuar me tri listat sepse ishte oferta me çmim ma të lirë nga te gjithë ofertuesit oferta financiare ishte 382 455.70 ndërsa oferta e OE ankues ishte 453,761.00 dallimi në çmim ishte mbi 71,000.00€

Andaj pasi që Listat janë dorëzuar me rastin e ofertimit kerkesat per deshmi në kuader të listave të prezentuar nga ana e AK ishin në harmoni me nenin 59 dhe 72 si dhe dhëzuesin nr 001/2023 për prokurim publik.

Sa i perket pretendimit nr 4 të OE ankues se nuk e ka tejkaluar buxhetin e paraparë sepse i njejti thekson se ka ofertuar me meter /kub që i bie 77.00€ per meter kub qe do me than se 1m kub dru =1.43 meter hapsirë ,eksperti sqaron se te pershkrimi i çmimit ka qenë e përcaktuarë për te gjithë ofertuesit pershkrimi i njejt dhe OE ankues ka ofertuar me çmim m3 siq ishte paraparë dhe sikur kanë ofertuar te gjithë ofertuesit tjerë mirëpo i njejti ishte me çmim mbi 71 000.00€ ma te lart se sa oferta e shpallur fitues .

Andaj ,

Eksperti konstaton se nuk qendron pretendimi i OE ankues sepse AK ka vepruar në harmoni me nenin 59 dhe 72 të LPP-së .

Përgjigje në Pretendimi nr.3 .

Operatori Ekonomik Pylla sh.p.k - Gjilan - pretendon se Autoriteti Kontratues Komuna e Gjilanit - Departamenti i Prokurimit nuk e ka respektuar nenin 62 pika 1 dhe 1.1 të LPP-së ,

Eksperti thekson se qellim i neni 62 është apo i njejti nenë sqaron se kur duhet te anulohet një aktivitet i prokurimit i cili nuk do rezultoj me dhenje të kontrates ,si dhe par. 1.1 tregon per rastet kur një shkelje e LPP ka ndodhur dhe nuk mundë te rregullohet apo te parandalohet permes një amandamenti ligjor ,duke perfshir rastet kur nje dispozitë e ketij ligji kerkon anulimin e aktivitetit te prokurimit .

OE ankues pretendon se OE i shpallur fitues nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me

NJK dhe DT dhe i njejti pretendon se nese Oferta e OE ankues e ka tejkaluar buxhetin e paparë aktiviteti i prokurimit do duhej të anulohej .

Eksperit sqaron se nuk qendron pretendimi i OE ankues sepse OE i shpallur fitues siq u sqarua në pretendimin paraprak i ka plotsuar kriteret e parapara me NJK dhe DT. dhe ka ofertuar me çmim më të lirë ,sikurse u sqarua në pretendimin paraprak (2 dhe 4 lidhur me shkeljet e nenit 59 dhe 72)

Andaj,

Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.5 .

Operatori Ekonomik Pylla sh.p.k - Gjilan - pretendon se Autoriteti Kontratues Komuna e Gjilanit - Departamenti i Prokurimit nuk e ka respektuar nenin 69 të LPP-së ,

Eksperti thekson se qellimi i ketij neni ka te bejë me aftësin teknike dhe profesionale .

OE ankues pretendon se AK nuk ka pasur te drejtë të i kerkojë informacione shtesë lidhur me listat e dorëzuara të cilat u shqyrtuaan në pretendimin 2 dhe 4 të kesajë ekspertize te njejta pretendimie nuk qendrojn siq u sqaruan në pretendimet e permendura me lart (pretendimi 2 dhe 4 te ketijë raporti)

Andaj,

Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" Pylla " SH.P.K.**

Bujar Lushaku